

RELACION DHE SPECIFIKIME TEKNIKE PËR OBJEKTIN:

“Pastrimi, grumbullimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane dhe të ngurta. Mirëmbajtja e hapësirave publike dhe e varrezave për Njesinë Administrative Milot dhe Fushë Kuqe”.

TË PËRGJITHSHME


Bashkia Kurbin ka si qëllim ofrimin e shërbimit të Pastrimit në të gjithë territorin e saj aktual me standarte dhe përformancë sa më të larta, duke siguruar reduktimin e impakteve negative të mbetjeve, në shëndetin e njerëzve dhe të mjedisit.

- Kompania private duhet të kryejë grumbullimin dhe transportin e mbeturinave të prodhuara në njesine administrative Milot dhe Fushe Kuqe dhe të realizojë depozitimin e tyre në landfillin e Bushatit.
- Është parashikuar që në njesine administrative Milot dhe Fushe Kuqe çdo ditë prodhohen respektivisht 11.7-12 ton/ditë mbetje urbane.
- Gjithashtu kompania duhet të kryejë edhe zëra të tjerë shërbimi të detajuara si më poshtë sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor dhe preventivit të shërbimit.



E rëndësishme.

Llogaritja e koston për shërbimin e Pastrimit do të bëhet sipas modelit “ Për miratimin e masave për koston e menaxhimit të integruar të mbetjeve “Miratuar me VKM nr.319 datë 31.05.2018. Këtu përfshihen të gjitha elementet e këtij shërbimi sipas specifikimeve të mëposhtme si dhe Planit të Menaxhimit të mbetjeve Kurbin. Proçes pune në vete jashtë kësaj metodologjie është dizefektimi i PGM , fshirja manual dhe mekanike, larje dhe lagje rrugësh, mirëmbajtje varrezave dhe hapësirave dhe sipërfaqeve te gjelberta. (çmimet e këtyre të fundit do të bëhen me analiza).



1. Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve

Volumet e punimeve

Në zonën Veri-Perendimore të bashkisë Kurbin bën pjesë Milot dhe Fushe Kuqe. Kjo zonë ka një popullsi prej **20 000**, banorë (sipas të dhënave nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë). Zona ka karakter kryesisht urban dhe rural të miksuar.

Në total në zonë gjenerohen **11.7-12 ton/ditë** mbetje të ngurta urbane, ose **4269** ton mbetje të ngurta urbane gjatë gjithë vitit, të cilat duhet të grumbullohen dhe transportohen në Landfillin e Bushatit çdo ditë të javës, sipas grafikut të miratuar nga Autoriteti Kontraktor dhe marrëveshjes me Landfillin e Bushatit.

Kjo sasi mbetjesh do të mblidhet në terren nga **120** kontenierë metalikë dhe plastike me kapacitet **1,100** litra ($1.1m^3$) secili, të shtrirë në të gjitha njësinë administrative, sipas **80** PGM përkatëse të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Këto kontenierë janë pronë e bashkisë.

Gjatësia totale e rrugës për grumbullimin e mbetjeve në territorin e në njësive administrative Milot dhe Fushe Kuqe është 50 km. Sipas planit të përcaktuar për vendosjen e pikave të grumbullimit të mbetjeve, distanca midis tyre varion nga **100 m - 500 m** larg.

Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në:

- a. Zbrazen e kontenierëve 1100 litër me makinën e përshtatshme teknologjike të përcaktuar, si dhe koshat e mbeturinave të vendosura në PGM.
- b. Mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 5 m nga çdo kontenier.
- c. Pastrimin dhe fshirjen me fshesë të sipërfaqes prej 20 m² rreth çdo pike grumbullimi.
- d. Rivendosja e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenierët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur.
- e. Klorifikimi i zonës së kazanëvë, sipas normativave.
- f. Larjen e kazanëve sipas grafikeve të miratuar.

- g. Mirëmbajtje dhe zevëndësim i koshave sipas kërkesës.
- h. Transportin e mbeturinave në Landfillin e Bushatit.

Frekuencat e grumbullimit

- a. Në zonën Qendër shërbimi i grumbullimit të mbetjeve do të ofrohet cdo ditë. Oraret e grumbullimit do të jenë natën, dhe në mëngjes heret nga ora 06.00 deri në orën 09.00, kështu do të evitohen orët me trafik.
- b. Mbetjet do të grumbullohen dy herë në ditë në 100 % të të gjitha pikave të grumbullimit të mbetjeve të qytetit cdo ditë të javës. Normalisht aty ku ka aktivitet më të dendur të bizneseve, orët e operimit për frekuencën e dytë do të jenë ndërmjet orës 18.00 dhe 21.00.
- c. Grumbullimi i rrymave të mbeturinave (të riciklsheme) do të kryhet me të gjitha bizneset që detyrimisht duhet të realizojnë një marrëveshje të drejtëpërdrejtë me Kontraktuesin.

Plani i vendosjes së kontenierëve dhe grafikët e punimeve :

- a. Autoriteti kontraktor ka përcaktuar pikat ekzakte të grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane, dhe numrit të kontenierëve për secilën pikë, në të gjithë zonën ku përfshihen edhe të gjitha pikat e grumbullimit .
- b. Kontraktuesi është i detyruar të zbatojë planin fillestar të pikave. Ky plan mund të ndryshojë gjatë kohës së zbatimit të kontratës me propozim të kontraktuesit ose nga Autoriteti kontraktor sipas nevojave për përmirësimin e shërbimit dhe mirë organizimit të tij, ose si rezultat i ndryshimeve që mund të ndodhin në infrastrukturë gjithmonë pas kërkesës së njëres palë dhe bëhen të zbatueshme pas miratimit të Autoritetit kontraktor.
- c. Autoritetit kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjopa për mospërmbylljen e tyre.

Rregulla për tu zbatuar

- a. Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të patransportuara dhe mbeturina të lëna në zonën përreth kontenierëve. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 1 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e kontraktuesit dhe do të vendosen penalitete.
- b. Kontraktuesi ka për detyrë të kryejë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane që depozitohen brenda zonës së kontraktuar edhe në rast se hidhen larg pikave të miratuara të grumbullimit të tyre. Në rastet kur mbetjet hidhen në mënyrë të përsëritur operatori i shërbimit ka të drejtë të kërkojë miratimin e vendosjes së kontenierëve dhe përfshirjen në grafikun e punimeve.
- c. Kontraktuesi duhet të ketë në efikasë një “Zyrë të Kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 07:00-16:00. Kontraktuesi duhet të vendosë dhe komunikojë përmes lyerjes së kamionit të pastrimit numrin e telefonit si dhe adresën e e-mailit për ankesa. Përfaqësues të kontraktuesit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontraktor dhe për t’u dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara pas marrjes së njoftimit. Kontraktori duhet të krijojë një listë (ose GIS) për ankesat me

indikacionin për vendodhjen, tipin, përshkrimin dhe përcaktimin e masës së marrë. Kontraktori do të sigurojë një kopje javore të kësaj liste për Bashkinë.

d.Kontraktuesi detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, pajisjeve dhe punonjesve.

e.Kontraktuesi detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve të transportit dhe shoferëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

f.Në asnjë rast nuk duhet të kryhet largimi i mbeturinave urbane nga kontenierët në akset kryesore, para se të jetë kryer fshirja dhe pastrimi i rrugëve ku ndodhen. Në të kundërt operatori i shërbimit duhet kryejë përsëri zbrazen e kontenierëve pa shpenzime ose duhet të përdorë mjete shtesë për të garantuar që kontenierët të jenë bosh pas përfundimit të të gjitha shërbimeve të pastrimit.

g.N.q.s gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rëna gjatë transportit, ai do të përballlet me penaltetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjoba të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

i. Përdorimi i uniformave dhe masave të sigurimit teknik për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mozbatimi aplikohen gjoba për mosplotësim këtij detyrimi.

Mjetet e grumbullimit do të jenë të paisura me llampa sinjalizuese përpara si dhe prapa kamionit, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e punonjësve. Këto llampa do të jenë gjithë kohës funksionale gjatë punës natën.

Mjetet dhe pajisjet


Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, (mbledhjes, transportit, largimit të mbeturinave) dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:

Kërkesa për mjete.

Nr	Emërtimi I mjetit	Kapaciteti	Sasi cope)
1	Makinë teknologjike transportuese pastrimi	8-12 ton	1
2	Makinë teknologjike transportuese pastrimi	5-8 ton	1
3	Makinë teknologjike transportuese pastrimi	3-5 ton	1
3	Kamionçinë	3-5 ton	1
4	Fadrome		1
5	Mjet për lagie rruges etj (autobot uji)	Mbi 10,000 litra	1
6	Mjet teknologjik,Zetor ose te ngjashem per prerje me krahe anash rrugeve te ferrave dhe barishteve degeve te ndryshme.Krahjet te hapen deri ne 3 metra me mjetin prerës.	≥80 kuaj fuqi	1

Shembull se si duhet te jene mjetet teknologjike

Lloji i mjetit	Mjet teknologjik grumbullues dhe transportues (kompaktor)
Ngarkimi fundor i makinës (kapaciteti i mjetit)	8-12 ton 
Raporti i Kompaktimit	Komprimim të mjaftueshëm për të mbajtur sasinë e kërkuar të mbetjeve brenda volumit të kamionit .
Klasa e shkarkimit	Euro 5
Kapja dhe ngarkimi i mjetit në pjesën fundore	Duhet të jetë me krahë kapës për kontenierë me volum 1100 litra (1.1m³) 

a. Makinë teknologjike grumbulluese dhe transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 8-12 ton, komprimim të mjaftueshëm për të mbajtur sasinë e kërkuar të mbetjeve brenda volumit të kamionit (8-12 ton), jo më pak se **1 (nje) copë**;

b. Makinë teknologjike grumbulluese dhe transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5- 8 ton, komprimim të mjaftueshëm për të mbajtur sasinë e kërkuar të mbetjeve brenda volumit të kamionit (5-8 ton), jo më pak **1 (nje) copë**;

c. Makinë teknologjike grumbulluese dhe transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 3- 5 ton, komprimim të mjaftueshëm për të mbajtur sasinë e kërkuar të mbetjeve brenda volumit të kamionit (3-5 ton), jo më pak **1 (nje) copë**; shenim: Ky mjet eshte kerkuar qe ne rast se kemi mbetje ne sasi maksimale qe kemi llogaritur si dhe ne rast difektsh te ndonje mjeti.

d. Makinë kamionçinë 3- 5 ton, e cila do te perdoret per mbetjet qe do dalin nga fshirja e rrugeve, shesheve dhe hapsirave publike si dhe per transportin e konteniereve, jo më pak **1 (nje) copë**.

e. Fadrome, e cila do te perdoret per heqjen e trungjeve te pemeve, shkurreve te thara si dhe ne raste te tjera te nevojshme, jo më pak **1 (nje) copë**.

f. Mjet për lagie rrugesh (autobot uji) mbi 10.000 litra, i cili do te perdoret per lagien e rrugeve si dhe per vaditje ne zonat e caktuara nga Autoriteti Kontraktor, jo më pak **1 (nje) copë**.

g. Mjet teknologjik, Zetor ose te ngjashem per prerje me krahe anash rrugeve te ferrave dhe barishteve

degeve te ndryshme. Krahet te hapen deri ne 3 metra me mjetin preres, jo me pak se **1 (nje)** cope.

Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:

a. Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontraktor për gjëndjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre.

b. Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren, duhet të jenë të identifikuara nga Autoriteti kontraktor. Ato duhet të mbahen në gjëndje të pastër dhe të rregullt. Një pjesë e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të jenë gjëndje për të siguruar plotësimin e gatishmërisë së mjeteve.

c. Mjetet e largimit të mbeturinave duhet të lahen dhe dezinfektohen çdo ditë pas përfundimit të punës.

d. Detyrimisht në të gjithë makinat duhet të shkruhen mesazhe për edukimin mjedisor, numri i telefoni i gjelbër i Autoritetit kontraktor/ emaili i AK, sipas një formati të miratuar paraprakisht po nga Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu në të gjitha mjetet përveç mbishkrimeve të mësipërme, duhet të prezantohen shpjegues të qartë për llojin e mbeturinave që mbledhen, si dhe orarin kur largohen mbeturinat.

e. Autoriteti Kontraktor në plan ka parashikuar një grafik të lëvizjes së mjeteve, por Kontraktuesi duhet të mundësojë një hartë të rrugës më eficiente që duhet të ndjeke mjeti për grumbullimin e mbetjeve në zonën përkatëse dhe grafikun përkatës.

Kushtet teknike për mjetet e transportit

a. Të gjitha mjetet e transportit duhet të jenë në gjëndje të mirë teknike për të mundësuar grumbullimin e mbeturinave.

b. Makinat teknologjike duhet të kenë një sistem ngarkimi të përshtatshëm me kontenierët që do të përdoren në NjA.

c. Sistemi mekanik i ngarkimit duhet të jetë i gjithi funksional dhe të lejojë kryerjen e një cikli të plotë (ngritjen e kontenierit, shkarkimin dhe uljen e tij (130 kg) në një periudhë kohore të limituar prej 20 sekondash.

d. Sistemi mekanik i ngritjes duhet të funksionojë vete dhe nuk duhet që punëtorët të ngrënë kontenierin për ta varur atë në këtë sistem.

e. Makinat teknologjike duhet të jetë në një gjëndje të mirë, pa rrjedhje të ndonjë fluidi, dhe në gjëndje të punojë 8 orë në ditë në mënyrë të vazhdueshme pa ndërprerje për arsye mekanike. Gjithashtu ato duhet të jenë të aftë për të lëvizur me një shpejtësi deri në 80 km/h.

f. Shkarkimet e gazërave të djegies nga makinat teknologjike duhet të jenë në përputhje me normat e legjislacionit në fuqi.

g. Dritat e përparme dhe të pasmet duhet të jenë në gjëndje të mirë dhe makinat duhet të jetë gjithashtu të pajisur me reflektorë. Dritë të bardhë të pasme për punën gjatë orëve të natës.

h. Makinat teknologjike duhet të jenë të pajisur me pasqyra të jashtme për të pasur një vision të qartë mbrapa, me mbajtëse/suport për puntorët, me sistem komunikimi (radio ose telefona) të cilat duhet të jenë të lidhura me qendrën e operimit.

i. Sistemi i ngjeshjes duhet të jetë në gjendje të mirë për të lejuar një shkallë të mirë ngjeshje për të realizuar ngarkimin e sasisë së kërkuar të mbeturinave brenda volumit të kamionit (respektivisht 8-12 dhe 5-8 ton)

j. Të gjitha investimet, mirëmbajtja dhe në qoftë se është e nevojshme edhe kostot e zëvendësimit të pjesëve janë të gjitha për t'u paguar nga kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen e të gjitha makinave dhe për faktin që ata duhet të jenë të gjithë në gjendje pune.

k. Në qoftë se një makinë është jashtë shërbimit, kontraktuesi duhet ta zëvendësojë atë me shpenzimet e tij me një makinë të ngjashme me të përgjatë gjithë kohës së riparimit të saj. Të tilla situata nuk duhet të kenë ndonjë influence apo ndikim mbi sasinë dhe cilesinë e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve.

l. Makinat teknologjike duhet të lahen cdo ditë dhe të tregohet kujdes për to. Ato duhet të sigurojnë një grumbullim të sigurt, të pastër dhe higjienik të mbetjeve.

m. Shoferi duhet të mbajë një libër ditor ku të tregojë të gjithë informacionin për punën e bërë cdo ditë: orën kur ka filluar grumbullimi, pushimet gjatë shërbimit, orët e shkarkimit, rrugët e bëra dhe kilometrat. Përfaqesues të bashkisë mund të kenë akses tek libri ditor sipas kërkesës.

n. Në qoftë se makinat teknologjike nuk do të plotësojnë këto kërkesa, si pasojë e neglizhencës në mirëmbajtje nga kompania, atëherë njësitë administrative duhet të kërkojnë zëvendësimin e tyre.

o. Çdo mjet duhet të jetë i lidhur përmes celularit me kompaninë në vazhdimësi.

p. Çdo mjet (duke përfshirë motorciklin) duhet të jetë i paisur me shuesin e zjarrit 6 kg, trekëndëshin e sigurisë, si dhe krik hidraulik.

Personeli

a. Personeli i nevojshëm për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave është një shofer dhe dy puntorë për çdo makinë që grumbullon mbetjet. Personeli nuk lejohet të kryejë riciklim në përfitim të tij apo të kompanisë gjatë orëve të punës së grumbullimit të mbetjeve në mënyrë që të evitohet humbja e kohës dhe nxitet grumbullimi. Riciklimi do të realizohet nga stafi dhe mjetet specifike. Gjatë transportit në landfill, punëtorët nuk duhet të shoqërojnë mjetin por duhet të ofrojnë të tjera shërbime pastrimi për qytetin.

b. Kushtet e punës për të gjithë stafin duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kështu stafi duhet të jetë i paisur me rrobat e përshtatshme të punës, me shenja dalluese që do të bëjnë të mundur identifikimin e tyre dhe gjatë natës, me doreza dhe paisje të tjera mbrojtëse për sigurimin teknik nëpunë.

Paimet minimale të kërkuar për stafin janë:

- Veshje me vizibilitet të lartë për periudhën e verës dhe dimrit
- Pantallona me vizibilitet të lartë
- Doreza
- Maska pluhuri
- Këpucë sigurie (pune)

Paimet do të zëvendosohen dhe pastrohen kur të jetë e nevojshme nga kompania kështu që punonjësit do të pajisen me to gjatë gjithë orëve të punës.

- Kërkesa për puntori, minimumi i kërkuar:

Nr	Specialiteti	Njesi	Sasi
1	Shofere	persona	4
2	Punetor makine per grumbullim mbetjesh	persona	6
3	Puntore per fshirje rruge, sheshe dhe trotuare me krahe	persona	5
4	Punetor per mirembajtje te varrezave dhe hapesirave publike	persona	4
5	Drejtuesi teknik / personi i kontaktit me AK	persona	1
	TOTAL		20

Shënim: Puntoria është kerkuar bazuar ne analizat qe kemi bere per secilin zë sherbimi,(analiza te cilat janë bashkelidhur ketij relacioni).

Kompania do të sigurojë një dhomë (garderober) për të gjithë punonjësit, në të cilën ato mund të ndërrojnë apo ruajnë veshjet e tyre cdo ditë, të lahen dhe pastrojnë duart përpara se të ikin në shtëpi. Do të jetë e ndaluar që punonjësit të kthehen në shtëpi me uniformat e punës, në mënyrë që të mbrohet familja e tyre nga papastërtit e mbetjeve. Në të njëjtën mënyrë një zgjidhje për pastrimin e duarve do të sigurohet edhe përpara se punonjësit të hanë.

Kompania duhet të organizojë pastrimin e uniformave çdo javë.

2. Dezifektimi i PGM

Volumet e punimeve

a.Duhet të bëhet dezifektimi i zonës perrëth kontenierëve, pas zbrazjes së çdo kontenieri, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori, duke përdorur sistemin e dezifektimit manuale, duke përdorur të tretur lëndën e pluhurit të gëlqeres me 5% përmbajtje klori.

b.Frekuenca e dizifektimit është 2 (dy) herë në javë për periudhën Maj-Shtator (ditën e mërkure dhe shtunë), ndërsa per periudhën tjetër të vitit, Tetor - Prill 2 (dy) herë në muaj.

3. Menaxhim dhe mirembajtja kontenieresh.

Pronësia e kontenierëve është e Autoritetit Kontraktor, ndërsa Kontraktuesi do të jenë përgjegjës për ruajtjen, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Menaxhimi i kontenierëve:

a.Vendosja e kontenierëve do të përcaktohet nga Autoriteti Kontraktor. Gjatë zbatimit të kontratës, kontraktuesi mund të zhvendosin kontenierë (duke ruajtur numrin rendor të tyre) në sajë të një kërkesë fillestare të bërë dhe të miratuar nga Autoriteti Kontraktor. Të gjitha lëvizjet e kontenierëve janë të përfshirë në çmimin e kontratës. Kontraktuesi duhet të ketë një mjet që do të mundësojë zhvendosjen e të paktën 6 kontenierëve (kamiocinë).

b.Kontenierët do të identifikohen me një numër rendor dhe një barkod, që do të mundësojë identifikimin digital të tyre nga grupi i monitorimit në Bashki. Kontraktuesi duhet të mbajnë një database me të gjithë kontenierët, ku identifikohet pozicioni, numri, moshë, kushtet dhe riparimet. Shërbimet e bashkisë do të kenë akses të përhershëm në leximin e kësaj database .

Mirëmbajtja e kontenierëve:

a.Kontenierët e dëmtuar sistematikisht duhet të zëvendësohen me një të riparuar, transportohen dhe rregullohen nga kontraktuesi. Kontraktuesi ka për detyrë të monitorojnë rregullisht gjendjen fizike të kontenierëve, dhe të mbajnë një inventar për të gjithë kontenierët, të cilin duhet ta raportojë tek Autoriteti Kontraktues. Në këtë inventar kontraktuesi duhet të japin sugjerimet në rast të nevojës për zëvendësim të kontenierëve, atëherë kur është e nevojshme si shtesë e kontenierëve të siguruar sipas pikës 3.1.c . Për të riparuar kontenierët, kontraktuesi duhet të ketë një mjet të veçantë për transportin e kontenierëve për t'i riparuar ato në ambjentet e kompanisë.

b.Kontraktuesi duhet të mbajnë një rezervë prej 5(pese) kontenierësh, të cilët do të përdoren për zëvendësimin e atyre të cilët do të shkojnë për riparim. Dëmtimet e mundshme, të cilat duhet të riparohen mbrenda 5- ditëve të evidentimit, janë:

- rrotat,
- kapakët,
- dorezat,
- deformime të ndryshme të kontenierit.
- lyerja e kontenierëve, numri serial dhe barkodi

c.Përsa kohë kontenierët janë projektuar për një përdorim intensiv, ata duhet të kenë nevojë për riparime nëse ato trajtohen ashtu siç duhet gjatë procesit të grumbullimit të mbetjeve. Pas grumbullimit kontenierët duhet të vendosen në pozicionin e tyre të mëparshëm.

d.Kontraktuesi duhet të kenë në dispozicion materialet dhe stafin e përshtatshëm për të realizuar këtë shërbim si dhe një oficinë të pajisur me mjetet dhe pajisjet e nevojshme.

Larja e kontenierëve

Operatori i shërbimit do të lajë dhe dezinfektojë 120 kontenierë të volumeve 1.1 m³/ brenda muajit ose mesatarisht 4-5 kontenierë/ditë, sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontraktor.

• Metodologjia

1. Operatori i shërbimit do të grumbullojë dhe transportojë kontenierët çdo natë në autoparkun e tij dhe të kryejë larjen e plotë dhe dezinfektimin e tyre atje. Kontenierët do të largohen detyrimisht pas zbrazjes së plotë të tyre, dhe zëvendësimin me kontenier të pastruar. Për të mundësuar kryerjen e këtij shërbimi operatori i shërbimit do të ketë në dispozicion një numër të nevojshëm kontenierësh rezervë për të zëvendësuar çdo natë kontenierët e larguar për tu larë.

2. Kontenierët për mbledhjen e mbeturinave urbane detyrimisht lahen nga brenda dhe nga jashtë me ujë me presion, duke përdorur furçe dhe solucione larëse. Ofruesi i shërbimit do të sigurojë një vend të posaçëm për këtë, përfshirë instalimin e sistemit të trajtimit të ujit me presion të lartë, ndarjes së vajrave dhe shtratit të mbetjeve. Ky instalim do të pastrohet aq herë sa është e nevojshme nga ofruesi i shërbimit. Përdorimi i ujit, produkteve dhe energjisë do të jetë e financuar nga ofruesi i shërbimit. Shërbimet e bashkisë do të mund të inspektojnë vendin në çdo kohë.

3. Me shërbim dezinfektimi kuptojmë realizimin shërbimit të dezinfektimit dhe deratizimit të të gjithë sipërfaqes së jashtme dhe të brendshme të kontenierit.

• Grafikët e punimeve

1. Grafikët e punimeve për transportin, larjen e kontenierëve, përgatiten nga Kontraktuesi dhe miratohen nga Autoriteti kontraktor.
2. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga Kontraktuesi.
3. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërmbyshjen e tyre.

- **Mjetet dhe pajisjet**

1. Makinë transportuese të kontenierëve (kamiocine), jo më pak se **1 (një) copë**.
2. Lëndë dezinfektuese dhe aromatizuese për dezinfektimin e kontenierëve.
3. Operatori i shërbimit duhet të ketë të instaluar në autoparkun e tij depozitë uji dhe një tjetër për lëndën dezinfektuese si dhe mjete pune (pompë dhe pistoletë uji) për larjen me presion dhe dezinfektimin e kontenierëve.
4. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.

4. Fshirja e manuale e rrugëve, sheshe dhe trotuare

Volumet e Punimeve

Autoriteti kontraktor ka parashikuar për fshirjen manuale sheshet, rrugët, trotuaret dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e kontraktuar, sipas grafikut dhe hartave bashkelidhur.

Operatori i shërbimit do të fshijë me krahë dhe do të kryejë të gjitha shërbimet e tjera mbështetëse parashikuar në metodologji për të gjitha rrugët, sheshet dhe trotuaret e përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, në një sipërfaqe të përgjithshme prej **42 ,959 m2** në ditë (7 ditë/javë). Këto janë parashikuar në grafikun e listës së rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e fshirjes për zonën, sipas hartave bashkëngjitur.

Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i fshirjes së rrugëve, shesheve dhe trotuareve me krahë konsiston në:

a. Fshirjen me punëtorë me fshesë të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore, duke mbuluar sipërfaqen e plotë të trotuarit dhe një sipërfaqe rruge 2 m nga kuneta, në gjithë gjatësinë lineare të saj, sipas hartave bashkelidhur.

b. Fshirjen dhe pastrimin me punëtorë pastrimi të gjitha segmenteve të zëna nga parkimi, trotuareve, dhe rrugëve dytësore.

e. Operatori i shërbimit duhet të zbrazë, pastrojë vendin përreth dhe të mbajë pastër çdo ditë të gjithë koshat rrugorë brenda zonës së kontraktuar. Për këtë operojnë punëtorë dhe makina të veçanta. Shërbimi i zbrazjes dhe pastrimit të ambjentit rreth tyre bëhet gjatë natës.

f. Proçesit të fshirjes dhe pastrimit i nënshtrohen të gjitha rrugët dhe trotuaret e parashikuara në zonën e kontraktuar (të asfaltuara, si dhe trotuaret e qytetit).

g. Në rastet e renies së deborës, shërbimi i fshirjes do të zëvendësohet me heqjen e deborës. Prioritetet e punës do të përcaktohen nga Bashkia duke konsideruar situatën.

Plani i punës dhe grafikët e punimeve

- a. Fshirja e rrugëve dhe hapesirave publike do të bëhet gjatë natës ose në mëngjes heret nga ora 05.00-08.00 dhe do të planifikohen në mënyrë që aktiviteti i fshirjes të kryhet përpara grumbullimit në secilin rrugë.
- b. Për pastrimin e rrugëve të pandriçuara Autoriteti kontraktor mund të ndryshojë dhe miratojë grafikun dhe oraret e shërbimit, pas kërkesës të njëres palë, për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit. Këtu mund të përfshihen edhe rrugët brenda blloqeve të banimit apo rrugët dytësore që kanë lehtësi pastrimi gjatë ditës nga mungesa e parkimit.
- c. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, përgatiten nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në destinacione apo dhe në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.
- d. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.
- e. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

Rregulla për t'u zbatuar

- a. Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 1 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik.
- b. Kontraktori detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.
- c. Për raste të veçanta Kontraktori është i detyruar të fshijë rrugët më shumë se një herë pa shpenzime.
- d. Gjatë procesit të fshirjes i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësjellësit, ujrave të zeza, hidrantëve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse, zonat e gjelbra, në banesat ujore natyrore apo artificiale, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie Kontraktori detyrohet t'i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes, përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballet me penalitete sipas kësaj kontrate dhe ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.
- e. Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjopa për mosplotësim të tyre.

Mjetet dhe pajisjet

Kontraktori duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me krahë të rrugëve dhe trotuareve si dhe të gjitha shërbimeve plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

- a. Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa, karroca dore, lopata, etj për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.
- b. Pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë.
- c. Punëtorët e fshirjes duhet të jenë të pajisur me uniforme. Paimet e personelit do të jenë sipas pikës 1.9.

7. Mirëmbajtje PGM gjatë ditës

Volumi i punimeve

Autoriteti kontraktor ka parashikuar shërbimin për të gjitha PGM e akseve kryesore dhe sipërfaqet e tyre përreth për të gjithë zonën e kontraktuar.

Kontraktuesi do të pastrojë dhe mirëmbajë të gjitha PGM e akseve kryesore të përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, nga ora 7.00 deri 15.00.

Këto janë parashikuar për shërbimin e mirëmbajtjes dhe pastrimit gjatë ditës të PGM sipas grafikut bashkëngjitur.

Specifikime teknike dhe metodologjia.

Shërbim i mirëmbajtjes dhe pastrimit të PGM të akseve kryesore, konsiston në:

- a. Mirëmbajtjen dhe pastrimin me punëtorë gjatë ditës të PGM, duke mbledhur dhe larguar të gjitha mbetjet e vogla dhe të mëdha të hedhura në sipërfaqet përreth tyre, si rezultat i aktivitetit tregtar dhe të këmbësorëve si dhe familjareve.
- b. Në rastet e evidentimit të një problematike të tillë, lajmërohet Kontraktuesi, i cili mbrenda 1 orë duhet ta eliminojë problemin, në të kundërt, penalizohet.
- c. Edukojë dhe komunikojë me popullsinë për sa i përket praktikave të mira dhe të këqija në përdorimin e kazaneve dhe pikave të grumbullimit.

Plani i punës dhe grafikët e punimeve

- a. Mirëmbajtja dhe pastrimi i PGM do të bëhet gjatë ditës nga ora 7.00 deri 15.00 .
- b. Mirëmbajtja dhe pastrimi i PGM do të kryhet sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me qëllim që gjatë gjithë ditës PGM e përcaktuar për shërbim të jenë krejtësisht e pastër ose duke u pastruar.
- c. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga Kontraktori. Kontraktori nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
- d. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

Rregulla për tu zbatuar

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen PGM të papastruara apo të mbushura me mbeturina. Në të gjitha rastet kur evidentohen raste të tilla, PGM e papastruar, lajmërohet Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet menjëherë të marrë masa për pastrimin e tyre brenda 1orë nga njohja e problemit. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit.

b. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të këtij shërbimi.

c. Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjopa për mosplotësim të tyre.

9- Lagia e rrugëve me makinë (Autobot Uji)

Volumet e Punimeve

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht të gjitha rrugët dhe sheshet me sipërfaqet e tyre të cilave u kryhet procesi i lagies në menyre manuale me Autobot Uji, për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të bëjë lagien e rrugëve me Autobot Uji, si shërbim për 120 ditë të vitit , në një sipërfaqe të përgjithshme prej **944,800 m²** ne muaj frekuence 7 ditë në javë. Shërbimi do të kryhet pas fshirjes së rrugës në mëngjes në turnin e dytë, midis orës 15:00 dhe 19:00 , duke ndjekur grafikun e miratuar nga Bashkia.

Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre sipas grafikeve për shërbimin e lagies me makineri per rruget si me poshte sipas hartave bashkelidhur:

1. Rruga Varrezave-Milot, siperfaqe 3780 m².
2. Rruga e tregut-Unaza e Qytetit, siperfaqe 6712 m².
3. Rruga Teqja Shullaz, siperfaqe 17,500 m².
4. Rrugicat Kalceto-Fushe shullaz, siperfaqe 6650 m².
5. Rrugicat Fshat Lac-Fushe Milot, siperfaqe 3180 m².
6. Rruga Rilindja-Qender 3320 m².
7. Rruga Mal Milot dhe shkolla e cila eshte 2200 m²

Specifikimet teknike dhe metodologjia

Shërbimi i lagies se rrugeve me Autobot Uji konsiston në:

Lagien e rrugeve, në mënyrë që të mbulojnë me shërbim lagie të gjitha sipërfaqet e plota të parashikuara në grafikët dhe hartat përkatës, me hedhje uji prej 1.5 mm (1.5 l/m²) dhe presion prej 5 deri ne 10 bar.

Plani i Punës dhe grafikët e punimeve

a.Lagia e rrugëve, si shërbim 120 ditor, do të kryhet me grafikë të miratuar nga Autoriteti kontraktor dhe sipas hartave bashkelidhur.

b.Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimeve të lagies së rrugëve, përgatiten nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.

c.Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga Kontraktori. Kontraktori nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

d. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

Rregulla për t'u zbatuar

a.Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kontrollojë gjatë kryerjes së shërbimit dhe pas përfundimit të tij, respektimin e standarteve në presionin e ujit për lagie si dhe duke kontrolluar herë pas here sasinë e ujit të përdorur për largien e sipërfaqes së parashikuar. Në rastet kur evidentohet presion i pamjaftueshëm në lagie apo sasi e vogël e ujit të përdorur, shërbimi i lagies do të konsiderohet i pavlefshëm.

b.Listat përkatëse të rrugëve që do lagen i bashkëngjiten këtij relacioni.

c. Të gjitha shpenzimet për ujin, që do të përdoret për lagie etj, do mbarten nga operatori i shërbimit.

Mjetet dhe pajisjet për lagies së rrugëve

a.Sipërmarrësi duhet të sigurojë për realizimin e lagies të rrugëve sipas përcaktimeve të kontratës, të gjitha punimet, materialet, pajisjet përkatëse.

b.Sipërmarrësi duhet të vërë në dispozicion dhe të përdorë për plotësimin e detyrave kontraktuale të lagies së rrugëve nje Autobot Uji.

c.Makina për lagien e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion (maksimumi 10 bar), me dy ose më shumë pjata larëse të orientueshme në pjesën e përparme, me sipërfaqe pune minimumi 2m dhe zorre uji për pastrimin e pikave të grumbullimit, me kapacitet mbajtës mbi 10,000 litra, jo më pak se **1 (një) copë**; Të jetë konform normave teknike të Komunitetit European.

d.Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren nga sipërmarrësi për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontraktor për gjëndjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre.

e.Të gjitha makinat për lagien e rrugëve duhet të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë, si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë.

f.Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.

g.Detyrimisht në të gjithë makinat duhet të shkruhet mesazhe për edukimin ambjental,numri i telefonit/email i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht.

10. Mbetjet e rënda dhe voluminoze

Kompania do të gjejë një zgjidhje për grumbullimin e mbetjeve të rënda dhe voluminoze dhe transportimin e tyre në landfill. Shërbimi i grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve të rënda dhe voluminoze do të organizohet me kosto të pronarit të mbetjeve. Me mbështetjen e Bashkisë, kompania do të zhvillojë fushatë komunikimi me qytetarët në mënyrë që të:

- ☐ Përcaktohet që të gjithë pronarët e mbetjeve të qojnë mbetjet e rënda dhe voluminoze në landfill me kosto të tyre.
- ☐ Propozojnë shërbimin e kompanisë për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve të rënda dhe voluminoze, sipas kërkesës dhe kositimit të përcaktuar nga kompania.
- ☐ Të përcaktojnë dhe vendosin kushtet për pranimin e mbetjeve të rënda dhe voluminoze.
- ☐ Të ndalojnë përdorimin e kazanëve të Bashkisë për evadimin e mbetjeve të rënda dhe voluminoze.
- ☐ Të përcaktojnë së bashku me Bashkinë penalitetet (të rënda) për hedhjen e mbeturinave të rënda dhe voluminoze në vendin e gabuar si koshat e mbeturinave, rrugë, hapsira publike, lumenj apo vendet private.

11. Mbetjet e kopshteve dhe sasite e medha të mbetjeve organike.

Kompania do të sigurojë një zgjidhje (vend specifik) për marrjen, trajtimin e mundshëm (kompostimin), dhe depozitimin e mbetjeve të pastra organike. Në bashkëpunim me Bashkinë, do të përcaktohet dhe organizohet vendi.

Me mbështetjen e Bashkisë, kompania do të zhvillojë fushatë komunikimi me pronarët e kopshteve dhe bizneset në mënyrë që:

- ☐ Të përcaktojnë që të gjithë pronarët e kopshteve dhe bizneset duhet të mbajnë mbetjet e tyre organike në kopësht, të kryejnë vetë aktivitetin e kompostimit ose të depozitojnë në vend mbetjet organike.
- ☐ Të përcaktojnë çmimin dhe kushtet për pranimin e mbetjeve organike në vendin e caktuar.
- ☐ Ndalojnë përdorimin e koshave të Bashkisë për evadimin e mbetjeve të kopshteve apo sasive të mëdha të mbetjeve organike (më shumë se 1 m³ / ditë ose 300 kg / ditë).
- ☐ Propozojnë ofrimin e shërbimit të depozitimit, grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve organike në vendin e dedikuar nga kompania, në vendin e përcaktuar nga kompania.
- ☐ Të përcaktojnë së bashku me Bashkinë, penalitetet (të rënda) për hedhjen e mbeturinave organike dhe të kopshteve në vendin e gabuar si rrugë, hapsira publike apo hapsirat private.
- ☐ Për këtë shërbim privat, kompania do të sigurojë kamionet dhe kontenieret specifik, me kosto të pronarëve të kopshteve ose të bizneseve të interesuara.

12. Vendi i depozitimit të mbetjeve

Mbetjet urbane do të depozitohen për trajtimin përfundimtar në landfill-in e Bushatit.

Pagesa për depozitimin në landfill do të bëhet nga ana e Autoritetit Kontraktor, sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen mes Bashkisë dhe Landfillit Bushat.

Mbetjet urbane të riciklueshme do të trajtohen nga vetë Kontraktori, sipas një marrëveshjeje që do të bëjë me bizneset.

Të gjitha mjetet e kompanisë që transportojnë mbetje në landfill, duhet të peshohen në hyrje

dhe në dalje nga landfilli. Statistikat për secilin mjet, përfshirë hyrjet dhe daljet, sasitë, datën, orën e hyrjes dhe orën e daljes, identifikimin e mjetit, duhet të regjistrohen dhe ti kalohen bashkisë një herë në ditë në format digjital excel.

Në fund të çdo muaji Kontraktuesi do të paraqesë mbikqyresit të punimeve (punonjësit të bashkisë), situacionin/et mujor të punimeve të kryera shoqëruar me procesverbalet përkatëse.

Çdo tentativë e shoferit apo e kompanisë për të ndryshuar rezultatet e peshimit të mbetjeve dhe të japë vlera të gabuara për mbetjet e transportuara do të qojë drejt penalteteve, shpërblyesive të mundshme të kontratës si dhe / ose procedime penale.

13. “Edukimi Publik Mjedisor”

a. Në termin “Edukim Publik”, do të nënkuptohet aktiviteti publicitar i Kontraktorit për të rritur dhe përmirësuar njohuritë e konsumatorit përsa i përket mbledhjes, përpunimit dhe largimit të mbetjeve, grafiket, rrugetimet, praktikën e mira dhe të keqja të qytetareve dhe bizneseve, ndarjes së mbetjeve në burim, etj periudhës së kontratës.

b. Kontraktori duhet të krijojë një kontakt të vazhdueshëm me komunitetin e zonës i cili luan një rol të rëndësishëm jo vetëm në mbarëvajtjen e punës së Kontraktorit por edhe në minimizimin e ndotjes së ambientit.

c. Kontraktori duhet të mundësojë shpërndarjen e materialeve informative një herë në 3-muaj. Materialet informative duhet të jenë në formën, fletëpalosjeve si dhe broshurave duke përfshirë në to informacione mbi shkaqet dhe shkaktarët e kësaj ndotje, parandalimin e saj si dhe masat që mund të merren për minimizimin e ndotjes. Materialet sensibilizuese duhet të jenë të tilla që të ftojnë banorët për tu bërë pjesë aktive e një shoqërie të emancipuar dhe me një edukatë mjedisore.

d. Kontraktori duhet të sensibilizojë banorët nëpërmjet programit të edukimit publik mjedisor që perkon në përputhje me planin e ndryshimit të parkimit, në rrugë dhe ditë të caktuara, për të mundësuar fshirjen më me cilësi të këtyre rrugëve.

e. Buxheti që Sipërmarrësi duhet të shpenzojë për edukimin mjedisor, është i përfshirë në koston e zërit të shërbimit “Grumbullim ,transport i mbetjeve urbane” (sipas llogaritjes së koston në bazë të VKM).

II. MIREMBAJTJA E VARREZAVE DHE HAPESIRAVE PUBLIKE

- ✓ Identifikimi dhe përshkrimi i shërbimit.

Volumi i punimeve të mirëmbajtjes së varrezave dhe hapësirave publike përfshin gjelberimin dhe është i identifikuar dhe përshkruar në grupe të veçanta, në të cilat janë caktuar me zëra të hollësishëm të gjitha volume përkatëse për çdo zë shërbimi mirëmbajtje, duke respektuar manualin teknik dhe eksperiencën e punës së deri tanishme.

Grupi kryesor i shërbimeve është:

1. Mirëmbajtje e Sipërfaqeve të gjelbërta për zëra të mëposhtme:

- a. Mirëmbajtje dhe pastrim i barit natyral.
- b. Mirëmbajtje pemë dekorative.

- c. Mirembajtje shkurre Dekorative.
- d. Mbjellje bari natyral te kultivuar.

Per te gjithë zerat e mesiperm bashkelidhur jane hartat perkatese.

Klasifikimi tipologjik i shërbimit:

Sipërfaqet e gjelbërta ose lulishtet janë klasifikuar sipas intensitetit të gjelbërimit në tre kategori Tipi A, B dhe C përcaktuar si më poshtë:

- Tipin A (intensive), (përfshihen kopshtet dhe parqet urbane, të kushtëzuar nga fluksi dhe frekuentimi i lartë i këtyre ambienteve recreative.
- Tipi B (të rendesishme), (klasifikohet si gjelbërim intensive me vshërbime të ndryshme, zona të gjelbra të lagjeve, rreth rrotullime dhe parqe lojrash.
- Tipi C (mirëmbajtje të lartë) siç janë gjelbërime rrugor etj. qe kërkojnë mirëmbajtje të veçantë.

Proceset e punës:

*** - Mirembajtje dhe pastrim i barit natyral:**

Per kete ze eshte parashikuar sipas analizes se koston ku do te behet pastrim i pergjithshem me kreher 4 here ne vit, pastrim i cili do behet ne muajt Mars deri në Tetor, sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktor.

Kositja ose prerja e sipërfaqeve të barit, do të realizohet 4 herë në vit (4 kositje). Kositja do të kryhet në fillim të muajit Prill deri në fund të muajit Tetor. Këtë process do ta realizojmë me makina kositëse bari dhe mjete tjera prerese. Krahas saj në vënde ku do të ketë dëmtime të sipërfaqes së barit do të bëhet riparimi i këtyre sipërfaqeve nëpërmjet mbjelljes me farë bari (referuar analizez se koston).

Pas procesit te pastrimit dhe prerjes se barit do te behet mbledhja dhe grumbullimi i mbeturinave si dhe transportimi i tyre ne vendet e kompostimit.

Gjithashtu pas procesit te prerjes se barit sipas nevojave do te behet shpërndarje e plehu organik dhe kimik gjatë muajit Tetor-Nentor dhe Shkurt-Mars.

*** - Mirembajtje pemë dekorative:**

Procesi i mirembajtjes se pemeve dekorative përfshin të gjitha ndërhyrjet prerëse apo krasitjeje që duhen kryer për një dru ose pemë të shëndetshme por edhe për nevoja të aksesueshmërisë, trafiku dhe sigurie (vizibilitet për kalimtarët, tabelat sinjalizuese etj.

Punimet kryesore në mirëmbajtjen e pemeve dekorative janë:

- ✓ Krasitja e tyre, që realizohet në periudhen Dhjetor-Shkurt, periudhe në të cilën druret janë në qetësi relative;
- ✓ Janë të parashikuara dhe proceset e punimit të tokës perreth drureve dhe eliminimit të barërave te këqija perreth tyre;
- ✓ Për pemet dekorative është parashikuar gjithashtu krasitja e tyre dy herë në vit duke i dhënë forma të ndryshme dekorative. Krasitjet e përvitshme dhe punimet e tokës perreth drurëve me qëllim eliminimin e barërave 2 here ne vit. Puna përfshin krasitjen rivitalizuese që duhet të kryhet për ekzemplarët e çdo lloji tipi sipas madhësisë dhe llojit. Ndërhyrja parashikon kontrollin konstant të pëmëtarisë përmes heqjes së degëve te thara e të prishura apo te rrezikshme, të degëve të dobëta dhe të holla qe formohen zakonisht në qendër të kukorës.
- ✓ Është planifikuar hapja e gropave per mbjellje te fidaneve, transporti i dheut vegjetal dhe plehut që do përdoret për mbjellje peme dekorative.

- ✓ Element i rendesishem është vaditja e drurëve gjatë periudhes së thatësirës etj.
- ✓ Pas procesit të krasitjes do të behet mbledhja dhe grumbullimi i degeve të krasitura si dhe transportimi i tyre në vendet e kompostimit

Shpërndarje plehu organik ;

Kryesisht realizohet gjatë muajve Janar-Shkurt dhe ka si qëllim pasurimin e tokës me lëndë ushqyese. Kryesisht shpërndahet gjatë punimit të tokës përreth pemëve, gjithnjë aty ku shikohet e nevojshme për një zhvillim të mirë të bimësisë dekorative.

Luftimi i sëmundjeve (spërkatje);

Është një proces që realizohet gjatë muajve Maj-Qershor dhe ka për qëllim luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve tek pemet. Përdoret dhe për luftimin e insekteve të ndryshme për të ruajtur bimësinë dekorative. Spërkatja realizohet dhe në raste të tjera për luftimin e barërave të këqija në sipërfaqet e barit aty ku ka zhvillim të madh të barërave që duhen hequr.

Pemet që do mbillen

Pemet që do mbillen do të jenë disa tipesh, të cilat do të përcaktohen në numra dhe lloje në bashkëpunim me specialistët e Bashkisë, duke i harmonizuar në plan-vendosje. Plani i mbjelljeve dhe lloji i drurëve do të miratohen nga njësitë e monitorimit në përshtatje me llojin e drurëve ekzistues në rrugë dhe lulishte. Pemet do të jenë të tipeve, Blin, Rrapa, Magnolia Santangeana, Fotinja, Agrifolia, Bredh..

Pemë dekorative specifitime teknike të përgjithshme

- Trupi i tyre duhet të jetë i drejtë dhe i padëmtuar.
- Kurora e fidanit duhet të jetë e zhvilluar mirë dhe duhet të ketë më shumë se tre degëzime.
- Nuk duhet të ketë degëzim të thatë.
- Sistemi rrënjor duhet të jetë i zhvilluar dhe i shëndetshëm.
- Ambalazhimi i rrënjëve duhet të jetë me qese/kove me diametër 30-40cm dhe lartësi 60cm, ose në vazo transplantuara qysh një vit më parë.
- Si trupi ashtu edhe degëzimet e fidanit duhet të jenë të pa infektuara dhe të padëmtuara nga insektet.
- Gjethet duhet të kenë ngjyrën karakteristike të kultivarit.

Kushtet teknike të veçanta

- Mosha e fidanit të drurit dekorativ duhet të jetë mbi 8 vjeç.
- Lartësia e fidanit pa sistem rrënjor duhet të jetë mbi 2 m.
- Diametri i qafës së rrënjës duhet të jetë jo më pak se 5 cm.
- Diametri i kercellit në 1m lartësi 3-5 cm.
- Lartësia e sistemit rrënjor duhet të jetë mbi 40 cm.
- Diametri i kurores së krasitur të jetë jo më pak se 50 cm.

***- Mirembajtje shkurre Dekorative:**

Në këtë veprimtarë parashikohet mirembajtja e shkurreve dekorative duke ju referuar disa proceseve si më poshtë:

Do të behet krasitja e shkurreve dekorative 2 herë në vit, si dhe krasitje forme 1 herë në vit duke i dhënë

formen e duhur dekorative. Do te behet prashitje dhe pastrim bari 2 here ne vit. Do behet punimi i tokës përreth tyre për eliminimin e barërave të këqija. Me rëndësi do të jetë dhe vaditja gjatë periudhes së verës (5 here ne vit) dhe aty ku nuk ka mundësi vaditje me tub uji do të perdorim botin e ujit për vaditje. Pas procesit te pastrimit dhe krasitjes do te behet mbledhja dhe grumbullimi i mbeturinave si dhe transportimi i tyre ne vendet e kompostimit.

Bordurat e gjelberta janë parashikuar të krasiten, me qellim mbajtjen e tyre ne format e duhura dekorative. Po kështu edhe punimet e tokës përreth ketyre gardheve. Krasitja e shkurreve do të kryhet: nje herë në muajin Prill dhe nje herë në muajin Korrik. Për shkurret gjethe rënëse krasitja bëhet gjatë dimrit dy herë në vit, ndersa për ato gjethe mbajttese krasitja behet edhe gjtë muajve të tjerë të vitit.

Mbjellja shkurreve dekorative

Në këtë zë janë parashikuar të mbillen shkurre dekorative. Është planifikuar hapja e gropës, transporti i dheut vegjetal dhe plehut që do përdoret për mbjellje. Vendi dhe lloji do të përcaktohen sipas planit të miratuar nga njësia e monitorimit të shërbimeve publike /Dreitoria e Shërbimeve Publike në përshtatje me llojin e shkures në rrugen apo lulishten përkatëse.

Edhe shkurret do te vendosen në bashkëpunim me specialistët e Bashkise dhe do jene disa llojesh. Shkurret do të jenë, Kalistemum, Fotinja, Spirea, Oleander, liguster, bush, kamelia.

Shpërndarje plehu organik ;

Kryesisht realizohet gjatë muajve Janar-Shkurt dhe ka si qellim pasurimin e tokës me lëndë ushqyese. Kryesisht shperndahet gjatë punimit të tokes perreth, shkurreve, bordurave të gjelberta gjithnje aty ku shikohet e nevojshme për një zhvillim të mirë te bimësisë dekorative.

Luftimi i sëmundjeve (spërkatje);

Është një proces qe realizohet gjate muajve Maj-Qershor dhe ka për qëllim luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve tek shkurret dekorative. Përdoret dhe për luftimin e insekteve te ndryshme për te ruajtur bimësinë decorative. Spërkatja realizohet dhe ne raste te tjera për luftimin e barërave te këqija ne sipërfaqet e barit aty ku ka zhvillim te madh te barërave qe duhen hequr.

Shkurret dekorative Kushte të përgjithshme

- Shkurret duhet të jenë me kërcell të rregullt me më shumë se 5 degëzime
- Me kurore të krasitur ose me forma pa demtime të bisqeve
- Pa degeza të thara
- Me sistem rrënjor të zhvilluar mirë dhe i shëndetshëm
- Rrënjët dhe degezimet të painfektuara dhe pa demtime nga insektet.
- Ambalazhimi i sistemit rrënjor duhet të jetë me qeska/vazo.

Kushtet teknike te veçanta

- Mosha 4-5 vjeçare
- Lartësia e fidanit pa sistem rrenjor duhet të jetë mbi 50 cm.
- Diametri i kurores së krasitur të jetë mbi 40 cm.
- Diametri i kercellit te jete mbi 1 cm.

*** - Mbjellje bari natyral te kultivuar:**

Do te behet mbjellja e barit ne disa zona te percaktuara nga Autoriteti Kontraktor, zona te cilat ka tharje bari dhe eshte e domosdoshme mbjellja.

Procesi i mbjelljes se barit natyral te kultivuar kalon neper disa faza:

Fillimisht behet punimi i tokes, frezimi, nivelimi, pleherimi pastaj behet mbjellja, mbulimi me kreher dhe ngjeshja.

Pas kesaj faze proces i rendesishem eshte vaditja e barit pas mbjelljes disa here dhe kryesisht në periudhen e verës (te pakten 8 here ne vit), e cila do të realizohet nëpermjet vaditjes me tuba, me sprucator dhe në ato vende ku mungon uji, vaditja do të realizohet me ujë me autobot. Vaditja është llogaritur të bëhet në varësi të mungeses së reshjeve në periudhen Maj-Tetor.

Kositja ose prerja e sipërfaqeve të barit, do të realizohet 4 herë në vit (referuar analizes 5.a). Kositja do të kryhet në fillim të muajit Prill deri në fund të muajit Tetor. Këtë process do ta realizojmë me makina kositëse bari dhe mjete tjera prerese. Krahas saj në vende ku do të ketë dëmtime të sipërfaqes së barit do të bëhet riparimi i këtyre sipërfaqeve nëpermjet mbjelljes me farë bari.

Do te behet shpërndarje plehu organik dhe kimik gjatë muajve Tetor-Nentor dhe janar-Shkurt.

Nitrifikim bari

Ky process pune realizohet zakonisht pas kositjes së sipërfaqes së barit kryesisht gjatë muajve Prill, Maj, Qershor, Korrik sipas karakteristikave dhe domosdoshmërisë që shfaq lulishtja. Nitratohet e gjithë sipërfaqja por edhe verifikohet aty ku bari ka njolla të verdha apo jeshile të zverdhur dhe nitrifikimi ka si qëllim që të fuqizojë zhvillimin e barit me qëllim që barit ë kthehet në ngjyrën e gjelbër normale. Nitrifikimi shoqërohet menjëherë me vaditjen me qëllim asimilimin sa më të shpejtë nga bari të elementit ushqyes azot.

Monitorimi dhe raportimi i shërbimit

Bashkia Kurbin realizon monitorimin e shërbimit të mirëmbatës së sipërfaqeve të gjelbërta përmes specialistëve dhe inspektorëve në terren. Grupi i monitorimit në bashki ka përgjegjësi për monitorimin e cilësisë dhe sasisë të shërbimit në të gjithë territorin e bashkisë. Organizimi dhe detyrat e grupit të monitorimit në bashki do të jenë:

Specialistët dhe inspektorët monitorojnë dhe raportojnë në njësinë e monitorimit të shërbimeve publike/drejtoria e shërbimeve publike për zbatimin e shërbimeve sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti Kontraktor Përcakton qartë penalitetet në rast të mos zbatimit të kushteve të kontratës;

Negocion me kompanitë në rast të mosmarrveshjeve.

Identifikon nevojat specifike dhe bën propozimet tek eprorët;

Jep informacion në rast të mungesës të cilësisë/sasisë kompanisë dhe inspektorëve e specialistëve që monitorojnë menjëherë;

Kontrolli i kontratës respektive, verifikimi i pagesave dhe propozimi i ndalesave dhe penalitetet

Mbikqyrësi i shërbimeve për problematikën e shfaqura jep urdhra te veçantë kompanisë së kontraktuar për marrjen e masave të menjëhershme për kryerjen e shërbimit të munguar sipas grafikut;

Kontrollon dhe verifikon faturat, në fund të cdo muaji harton proces-verbalin për mbylljen e situacionit të punimeve duke raportuar punët e kryera apo penalitetet/giobat e proceseve të punës të përealizuara.

Hartohen grafikët të cilët kanë të shprehur frekuencën e proceseve të punës që kryhen brënda muajit, mbi bazën e të cilit do të përcaktohet vlera e saktë e situacionit mujor .

Kompania/të Kontraktore

Kompania duhet të mbajë të dhëna ditore në lidhje me elementet e grafikëve te proceseve të punës dhe duhet t'i raportojë ato cdo muaj me shkrim tek specialistët qe monitoron shërbimin:

Rakordimi i grafikëve mujore për proceset e punës shoqëruar me çmimet njësore të proceseve.

Mbi bazën e këtyre grafikëve, jep vlerën në lekë për hartimin e situacioneve mujore, gjithnjë mbi bazën e ofertës totale.

GRUPI I PUNES:

1.Rudolf TOMA

2.Anton BROZI

3.Altin MARASHI

4.Dritan PREÇI

5.Kristo MARTINAJ

6.Françeska MARKU

7.Valentino HOTI

8.Emirjana SHPANI

MIRATOHET

KRYETAR

MAJLINDA CARA